**VENDIM**
**Nr.178, datë 3l.3.2005**

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE CIVILË, QË DALIN TË PAPUNË NGA REFORMA NË SHTËPINË E PUSHIMIT TË USHTARAKËVE, NË DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8930, datë 25.7.2002 "Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë", të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit civilë të shtëpisë së pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe filialit të saj në Sarandë, që dalin të papunë nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të trajtohen, për periudhën nga data 1.3.2005 deri më 31.3.2006, me pagën minimale, në shkallë vendi, ku të përfshihet edhe kontributi i sigurimit shoqëror.

2. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë punonjësit, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune deri në datën 28.2.2005.

3. Pagesa të bëhet çdo muaj nga zyrat përkatëse të punësimit, me fondet që, sipas pikës 5 të këtij vendimi, i shtohen Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

4. Kjo periudhë pagese t'u njihet këtyre punonjësve si periudhë sigurimi, për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti apo familjar dhe të shënohet në librezën e punës, pasi të bëhet pagesa e kontributit për sigurimet shoqërore, në përputhje me ligjin.

5. Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t'i shtohet fondi prej 9 800 000 (nëntë milionë e tetëqind mijë) lekësh, ku përfshihet edhe kontributi i sigurimeve shoqërore.

6. Ky fond të sigurohet si më poshtë vijon:

a) 8 300 000 (tetë milionë e treqind mijë) lekë nga të ardhurat e ish-shtëpisë së pushimit të ushtarakëve, Durrës;

b) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë nga Ministria e Mbrojtjes.

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.3.2005.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**